

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i per gjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjyqes Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. V. nga [REDAKTUE], per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr. [REDAKTUE] 2016 të datës 26.01.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore, në prezencën e Prokurorit Themelore te Shtetit në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit, me datë 24.01.2018, morri dhe shpalli publikisht këtë:**

### AKT GJYKIM

I akuzuari L. V. nga i ati H. e ema F. e vajzerise Sh. i lindur me dt. 17.08.1961 në Prizren, ku edhe jeton ne rr. [REDAKTUE] pn, i martuar baba i 3 femijeve, shkollen e mesme te kryer, punetor, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Prej dates se pavërtetuar e deri me dt. 06.10.2016 ne Prizren, pikerisht ne shtepin e tije, perfiton nga sherbimi komunal permes rrjetit perçues te rrymes apo rrjetit te shperndarjes pa autorizim te shfrytezuesit te autorizuar, ne ate menyre qe ka shfrytezuar energjin elektrike me njehsor i cili dy bllomba i ka te keputura ne mbrendi eshte demtuar diktuni i kapakut perreth qelqit nga ana e majte eshte futur shiriti filmik, eshte penguar puna e diskut, ashtu qe energjia e shpenzuar elektrike nuk regjistrohet me ç'rast ndermarrjes se demtuar Keds, departamenti ligjor ne Prizren, i ka shkaktuar dem material,

- kesodore ka kryer vepren penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es,


Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 46, 49 par.1.1, 50, 51, 73, 74, 75 e 76 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarit i shqipton:

### DENIM ME KUSHT

Ashtu qe verteton:

-Denimin me gjobe ne lartesi prej **150,00 euro** i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afat prej **1 viti** nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryen veper te re penale dhe,

Ashtu qe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej **3 muaj** i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **1 viti** nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk do te kryen ndonje veper te re penale.



I akuzuari eshte i obliguar qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedures penale sado qe te jene ato, ne emer te paushalit gjiqesor shumen prej **30,00 eurove**, ne afatin prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

| Perfaqesuesja e te demtuares KEDS – distrikti ne Prizren, per realizimin e kerkeses pasuroro juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

### A r s y e t i m

| Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr. [REDACTED] 016 te dt.24.01.2018, kunder te akuzuarit L. V. [REDACTED] per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila i vihet ne barre, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhje ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe e burgim me kusht qe denimet e njejtave nuk do te ekzekutohen nese ne periudhen prej 1 viti i akuzuari nuk do te kryeje veper te re penale, si masa sanksionuese te merituara paraprakisht duke e vertetuar perqjegjesine e tije penalo-juridike.

| Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaquerisht renduese, e si rrethane lethesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, ne kuptim te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin se i akuzuari ka bashkepunuar me gjykaten, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, gjer me tani i pa gjykuar,cka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, mbajtes i familjes 5 anetareshe, i gjendjes se dobet ekonomike, kompanis Keds ia ka paguar demin e shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi denimin e kushtezuar me gjobe e me kusht sepse konsideron se me me kete mase sankcionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i perqigjet shkalles se perqjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdeshhem dhe do te permabahet nga veprimet e tilla.

| Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451 te KPPK-se.

| Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr. 217/2017 Dites 24.01.2018

Sekretare Juridike  
Fatime Bajraktari



Gjyqtari  
Fatmir Krasniqi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjikimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.